



Të nderuar,

Në fillim të çdo viti, që kur jam emëruar kryetar i Trupit koordinues të Qeverisë së republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, përmes letrës ju kam dërguar raport për atë se çfarë është bërë gjatë vitit të kaluar. Kam nderin që edhe me anë të kësaj letre t'ju njoftoj për rezultatet e rëndësishme të punës së Trupit koordinues, si dhe për premtimet e realizuara që i kemi dhënë në fillim të vitit të kaluar.

Suksesi jonë më i rëndësishëm në vitin 2011, është hapja e degës së Fakultetit Ekonomik nga Subotica në Bujanoc. Fakulteti është hapur në tetor, kurse në gjeneratën e parë janë regjistruar 69 studentë të cilët mësimin e ndjekin në dy gjuhë, në gjuhën serbe dhe në gjuhën shqipe. Hapja e degës është shembull i zgjidhjes sistematike të arsimit në jug të Serbisë dhe punës së përbashkët të Qeverisë së Republikës së Serbisë, Trupit koordinues, Ministrisë së arsimit dhe shkencës, Qeverisë së Krahinës Autonome të Vojvodinës, Këshillit nacional të pakicës nacionale shqiptare, komunës së Bujanocit, Univerziteteve të Novi Sadit dhe Tetovës dhe Fakultetit ekonomik nga Subotica dhe Tetova në krijimin e kushteve për arsimimin e të rinjve në mjedisin multietnik.

Në vitin 2011 kemi filluar të zgjidhim problemin shumëvjeçar të përdorimit të librave në gjuhën shqipe. Trupi koordinues me Këshillin nacional të pakicës nacionale shqiptare dhe Ministrinë e arsimit dhe shkencës ka siguruar abetaren dhe fletoret e punës nga Republika e Shqipërisë, si dhe një numër të librave nga klasa e parë deri në klasën e katërt të shkollës fillore. Zgjidhja e çështjes së librave në gjuhën shqipe mbetet prioritet i Trupit koordinues edhe në vitin e ardhshëm.

Me bursimin e të rinjve nga komunat multietnike në jug të Serbisë është bërë hap i ri në realizimin e projektit të Qeverisë së Republikës së Serbisë për integrimin e tyre të mëtejme në jetën shoqërore të vendit. Pesë studentë të nacionalitetit shqiptar dhe gjashtë student të nacionalitetit serb kanë marrë indeksat e Univerzitetit në Novi Sad dhe bursat prej 45 mijë dinar në muaj.

Për herë të tretë janë ndarë bursa për 233 shkollarë të mesëm nga Presheva, Bujanoca dhe Medvegja, të cilët nuk e kanë njërin apo të dy prindërit, që kanë realizuar më së paku sukses të mirë në vitin e kaluar shkollor. Janë ndarë 27 bursa më shumë se sa në vitin e kaluar, kurse shuma e bursës është gjashtë mijë dinar në muaj.

Me qëllim të forcimit të ekonomisë në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, Trupi koordinues në vitin 2011 ka investuar në projekte të infrastrukturës 260,500.000.00 dinar.

Në komunën e Prshevës janë investuar 104,100.000.00 dinar për rekonstruimin dhe asfaltimin e rrugëve në fshatrat Rahovicë, Norçë dhe asfaltimi i rrugës lokale Zhunicë- Bushtan, Miratoc- Cakanoc, rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Raincë, rekonstruimi i rrugës në vendbanimin Stacioni hekurudhor, rekonstruimi i rrugës “Vëllezërit Frashëri”, adaptimi i Shtëpisë së Kulturës „Abdulla Krashnica”, si dhe për vazhdimin e ndërtimit të shkollës së mesme teknike “Presheva”.

Në komunën e Bujanocit janë investuar 115,600.000.00 dinar për adaptimin e Shtëpisë së kulturës për nevojat e Fakultetit ekonomik, adaptimin e rrugëve në fshatin Konçul, rrugën lokale e cila lidh fshatrat Nesalc dhe Verban, **Breznicën** e Epërme me **Breznicën** e Ulët, rrugët në fshatrat Baralevc, Kushticë dhe



Rakoc, renovimin e Shkollës fillore “Muharrem Kadriu” në Tërnocin e Madh, renovimi i katit të parë dhe ndërrimi i karpenterisë në shkollën fillore “Naim Frashëri”, vazhdimi i ndërtimit të sistemit të ujësjellësit në fshatin Letovicë, ndërtimi i kanalizimit në fshatin Bozhinjevc dhe asfaltimi i trotuarit në Bujanoc.

Në komunën e Medvegjës janë investuar 38.100.000.00 dinar për ndërtimin e rrugëve lokale Petrinje-Mrkonje, Cucki breg- M3 Retkocer, Lumi Misikiqi, Petrinje-Cokotin, sanimi i rrëshqitjes në rrugën Meda-Retkocer, mirëmbajtja e rrugëve lokale të mëhallave, ndërtimi i rrugës në Medvegjë dhe Banjë të Sijarinës, punët shtesë në sanimin e Sallës së Sportit.

Trupi koordinues dhe Ministria e shëndetësisë, në bashkëpunim me komunën e Preshevës, ka siguruar mjete për rekonstruimin e Shtëpisë së Shëndetit në Preshevë për nevojat e lindtores jashtëspitalore. Për shkak të ankesave në procedurën e prokurimit publik, ky projekt me rëndësi të jashtëzakonshme nuk ka filluar. Rekonstruimi i Shtëpisë së Shëndetit për nevojat e lindtores jashtëspitalore mbetet prioritet strategjik i Trupit koordinues për vitin 2012 dhe presim që deri në fund të vitit të ardhshëm do të realizohet edhe ky projekt me rëndësi të posaçme.

Trupi koordinues edhe këtë vit ka siguruar më shumë se 15, 000.000.00 milion dinar për projekte të shoqërisë civile. Për kategorinë sociale të popullatës secilës komunë iu janë ndarë nga dy milion dinar.

Me qëllim të përmirësimit të punësimit Trupi koordinues në bashkëpunim me institucionet republikane, ka mundësuar vazhdimin e politikës së punësimit në institucionet shtetërore, doganë, administratën tatimore, organet e inspektionit. Ministria e punëve të brendshme ka shpallur konkurs për trajnim themelor të policisë dhe grupi i ri i studentëve ka filluar kursin në dhjetor të vitit 2011.

Nga fondi i Ministrisë për administratë shtetërore dhe vetqeverisje lokale janë ndarë 41.183.000,00 dinar për zhvillimin e bashkësive lokale në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Në Preshevë janë siguruar mjete për përmirësimin e rrugëve në Strezoc dhe Sllavujevc, kanalizimin në Cakanoc, ndërrimin e karpenterisë në Shkollën fillore “9 Maji” në Relan, ndërtimin e çerdhes në fshatin Ashan me shumë prej 20,183,000,00 dinar. Për financimin e asfaltimit të rrugës në Levosovë, ndërtimi i trotuarit në qendër të qytetit dhe ndërtimi i amfiteatrit në Klenik, Bujanoc janë ndarë 13,000.000.00 dinar. Medvegja ka marrë 8,000.000.00 për financimin e ndërtimit të rrugëve lokale në bashkësitë lokale në Rujkoc dhe Cokotin.

Këto janë disa nga sukseset tona të përbashkëta në vitin 2011. Dëshiroj të paralajmëroj vazhdimin e politikës së Trupit koordinues në fushën e arsimit dhe punës me të rinjtë, punësimit dhe përkrahjes së zhvillimit të sektorit civil. Vëmendje të veçantë Trupi koordinues do t'i kushtoj zhvillimit të ekonomisë dhe stimulimit të zhvillimit ekonomik të komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Ju dëshiroj suksese në vitin 2012.

Me respekt,

Milan Marković

kryetar